



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 134

Prishtinë, më 24.12.2013, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S2 anex

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Boban Todorović.

Mungoi : Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj, Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 17.12.2013,
3. Hartimi i Ligjit mbi veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe me një plotësim rreth praktikantes që përfundon kontratën në këtë komision.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.12.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 17.12.2013 me përmirësime të **Afërdita Berishës** e cila ka potencu se Ligji për parkun duhet të mbrojë natyrën dhe biodiversitetin e assesit të ketë ingerenca në prone private, ndërsa **Nait Hasani-kryetar** në mbledhjen e fundit ka përfunduar me konstatimin se për kërkesën e parashtruar ky Komision nuk mund të rekomandojë ndërmarrjen e procedurave ngase ky kërkesë nuk plotëson kushtet formale.

3. Hartimi i Ligjit për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë

Kryetari i Komisionit Nait Hasani falënderoi Komisionin, grupin punues dhe së fundi Zyrën rregullator për ujë dhe kanalizim, rreth angazhimit për hartimin e këtij Ligji, procedurë kjo që parashihet sipas Nenit 53 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit. Ai konstatoi se Komisioni ka hartuar 44 Nene, ndërkaq **Salih Morina** shfrytëzoi rastin për të falënderuar Drejtorin e ZRRUK **Raif Pretenin** për mbështetje gjatë hartimit të Ligjit, sidomos në vizitat e kryera në Korçë dhe Tiranë, ku Komisioni ka shfrytëzuar përvojat e tyre për një ligj sa më të mirë. Gjithashtu edhe Drejtori i ZRRUK falënderoj për angazhimin e komisionit duke ofruar bashkëpunim edhe më të përafërt në të ardhmen me përvoja të reja në shtetet e rajonit. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET nisma për hartimin e Ligjit për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë, në bazë të Nenit 53 të Rregullores së Kuvendit, i cili dokument i hartuar do të procedohet më tutje në bazë të Nenit 55 të Rregullores.

4. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme **Kryetari Nait Hasani** rekomandoi komisionit për dy çështje si në vijim :

- të miratohet **Raporti njëvjeçar i punës** së komisionit për vitin 2013 i cili raport ju është dorëzuar anëtarëve prezent të komisionit, me çka Komisioni u pajtua, dhe
- Praktikantja **Flaka Broqi** është falënderuar nga Komisioni për angazhimin e treguar njëvjeçarë, dhe u vlerësua pozitivisht puna e sajë në këtë Komision. U Rekomandua në UNDP që e njëjta të angazhohet më tej në këtë Komision si mbështetje profesionale dhe teknike për vitin vijues 2014.

Kryetari Nait Hasani në përfundim të këtij viti, edhe një herë falënderoi dhe uroi vitin e ri 2014.

Mbledhja përfundoi në orën 14,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani